

## FJALA E DEPUTETIT LUÇIANO BOÇI

E ENJTE 10 MARS 2022

Edhe gënjeshtër skuqet para jush, kur ju dëgjon të flisni për suksesin e madh të inceneratorëve, sepse, fatmirësisht, me vajtjen tek inceneratori i Elbasanit, komisioni ynë zbuloi shumë gjëra. Unë i kam paraqitur pamjet e marra, dhe ky është ai mali i plehrave, pas 25 milionë eurove të hedhura në Elbasan. Dhe vërtet, në syrin tim ky mal nuk është 6 metra, si dikur ai i Fierit, siç u tha këtu, por të paktën është 3 metra. Elbasani vazhdon të helmohet, sepse së bashku me deputetët e majtë evidentuam se nuk ekziston dampa e hireve, që është elementi kryesor i punës fundore të inceneratorit, kështu që hiret kancerogjene shpërndareshin në landfill. Kjo e thënë me zë e me figurë nga përgjegjësit aktualë të inceneratorit të Elbasanit. Meqenëse përgjatë kësaj kohe nuk donit ta përqendronit debatin te procedura, por doni ta përqendroni tek ajo që e konsideroni si e mira dhe e bukura e inceneratorëve, kemi hulumtuar dhe ka vërtet shumë dokumente, shumë studime, të cilat tregojnë qartazi se inceneratorët nuk janë zgjidhja më e mire, janë një zgjidhje ndërmjet zgjidhjeve të tjera dhe jo të orientuar sipas strategjisë.

Strategjia nuk e përcakton incenerimin si elementin kyç të menaxhimit të mbetjeve, por ka riciklimin dhe seleksionimin e tyre, ndarjen e tyre në burim. Raportet ndërkombëtare dhe studimet tregojnë qartë faktin se inceneratori, sidomos për banorët që janë aty afër, shkakton kancer, se është bërë ky debat edhe me Kryeministrin në komision: kancer të mushkërive, kancer të mëlçisë, kancer të veshkave, kancer të rrugëve polmonare. Këto janë efekte që jepen në vazhdimësi, pra mos prisni që efektet e tyre të dalin pas një viti, kur ju keni korrur “suksesin”, mos prisni pas pesë vjetësh, por shiheni në vazhdimësi, sepse qyteti i Elbasanit e ka vuajtur dhe e vuan një gjë të tillë. Megjithatë, nuk doja ta nisja kështu, por ma imponuat, sepse kjo historia e grabitjes së 430 milionë eurove me anë të inceneratorëve, pavarësisht kohëzgjatjes, se ju mbroheni edhe pas kohëzgjatjes, i ngjan një filmi me skenar Hollivudi.

Në vitin 2014, tre personazhe krejt të panjohur për publikun shqiptar, krejt të panjohur për biznesin shqiptar deri në ato momente, që suksesin e tyre më të madh kishin kolaudimin e sahateve të ujit, papritur e pa kujtuar na dalin si shpikësit e mekanizmit të shpëtimit të vendit nga emergjenca e shpallur mjedisore. Pa asnjë përvojë në fushën e mbetjeve, pa asnjë kapital, por me vetëm 100 mijë lekë të vjetra, pa asnjë njohuri thelbësore për një nga aktivitetet më të debatuar sot në Europë, pra për inceneratorët, pa gjë prej gjëje, u bënë heronjtë miliarderë të tre koncesioneve korruptive. Me një projekt fillimisht copë-copë, të paraqitur, por në fakt me një projekt të rregullt për të ndarë copa dhe llokma me Ramën dhe qeveritarët e tij kryebashkiakë, morën përsipër djegien masive të parave të shqiptarëve. Ata kishin vetëm një talent: talentin për të qenë të përzgjedhurit dhe të besuarit e Kryeministrit, i cili në gjithë këtë histori është vetë skenaristi, vetë regjisori, vetë kryeheroi i kësaj skeme gjigante korruptive. Kjo është fabula e thjeshtëzuar, por në fakt, ajo çfarë ndodhi me inceneratorët, skema me procedurat e shkelura gjatë gjithë miratimit të tre inceneratorëve, është zbërthyer gjatë komisionit hetimor.

Praktikisht, gjithçka nisi kur në shkurt të vitit 2014 Edi Rama me urdhrin e tij për Komitetin për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve shpalli emergjencën mjedisore, një vendim i firmosur në minimumin e anëtarëve të tij dhe pa kompetenca për ta shpallur emergjencën mjedisore. Kjo emergjencë do të shndërrohej më pas në strumbullarin e të gjitha veprimeve të tjera, nga ku lindën emergjencat e tjera, me të cilat vetë Rama pohoi që ka marrëdhënie specifike, në fakt, kishte marrëdhënie specifike me plehrat, sepse emergjencat mjedisore, çuditërisht dhe rastësisht, u shpallën në ato bashki që ishin të keqmenaxhuara pikërisht nga drejtuesit socialistë. U shpall në Bashkinë e Elbasanit e drejtuar prej 20 vjetësh nga e majta, u shpall në Bashkinë e Fierit, e drejtuar prej 30 vjetësh nga e majta, u shpall në Bashkinë e Tiranës, e drejtuar nga vetë Edi Rama, u shpall në Bashkinë e Durrësit, e drejtuar prej 20 vjetësh nga Edi Rama. A ishte rastësi do të thoni ju? Jo, nuk ishte rastësi aspak, ishte ajo marrëdhënia specifike pikërisht me plehrat. Për të vazhduar, vetë Rama bëri veprimin tjetër, duke vendosur si autoritet kontraktor Ministrinë e Mjedisit. Kjo është shkelja e dytë ligjore e madhe, pasi në VKM-në e vitit 2013 Ministria e Mjedisit ishte vetëm ministri monitoruese, përgjegjësinë e menaxhimit të mbetjeve e kishte Ministria e Transporteve, kështu që ajo nuk mund ta merrte këtë kompetencë. Por, pasi mori këtë vendim dhe bëri këtë veprim, Rama vetë i lau duart dhe ua la të tjerëve topin që të vazhdonin të merreshin me procedurat korruptive.

Këtu është vendimi tjetër i vitit 2013, në të cilin Ministria e Mjedisit përcaktohet vetëm si monitoruese, pra vendim antiligjor i vetë Kryeministrit, të cilin ai mundohet ta shmangë dhe mundohet t'i fshihet këtij realiteti. Pas këtij vendimi Ministria e Mjedisit hyn në marrëdhënie me bashkitë e përcaktuara në emergjencë dhe përcaktojnë për të njëjtën arsye tri modele të ndryshme koncesioni. Në Elbasan u përcaktua me negociim pa shpallje, në Fier u bë garë e mbyllur, ndërsa forma e Tiranës pretendohet që është koncesion i pastër. Me të njëjtën mënyrë dhe me të njëjtën rrugë kemi tri forma të ndryshme të investimit të parave të publikut, gjë që lë dyshime jo thjesht për komisionin tonë, por edhe për organet e tjera për ndjekje të mëtejshme hetimore. Këtu dëgjova shumë arsyetime dhe justifikime për çështjen e inceneratorit të Elbasanit. U mor nga parafolësit çështja e 16 vendimeve brenda datës 16 dhjetor. Nuk kemi thënë 16 vendime, por kemi thënë 16 procedura, midis tyre kishte edhe vendime, dhe jo në datën 17, sepse, në kundërshtim me ligjin, në datën 17 miratohet nga vetë Rama financimi i inceneratorët të Elbasanit, ndërkohë që, pas miratimit të datës 16 duhej të kishte qëndruar i shpallur 7 ditë për të drejtën e ankimit, por kjo gjë nuk u zbatua, ndërkohë që vetë drejtuesit e institucioneve të tij, të APP-së, e kishin paralajmëruar Ramën që kjo mënyrë, ky negociim pa shpallje ishte antiligjor, madje ishte vënë në dijeni edhe sekretari i tij i Përgjithshëm, i cili, në kundërshtim me atë që është shënuar në raport, deklaroi në komision që procedura për inceneratorin e Elbasanit ishte një procedurë e përshpejtuar, por rastësisht qëlloi me një mbledhje normale të qeverisë të ditës së mërkurë dhe nuk është e vërtetë që i është nënshtruar një procedure të rregullt dhe të qetë.

Është e provuar përgjatë pyetjeve që iu bënë sekretarit të Përgjithshëm të Kryeministrit. Vetë Rama në dëshminë e tij lau duart dhe jo më kot i kërcënoi bashkëpunëtorët e tij që, në qoftë se ata do ta lëshonin atë, ai ishte i gatshëm t'i lëshonte një pas një në qelitë e burgut. Bëri një deklaratë të tillë, pasi, sipas tij, nuk kishte dijeni për asnjë nga vendimet që kishte marrë qeveria, as për miratimin e financimit, as për mënyrën e negociimit; nuk kishte dijeni që inceneratori i Fierit duhej t'i nënshtrohej një procedure me tenderim ndërkombëtar, sepse kalonte shumë më 10 milionë euro, nuk kishte dijeni që për inceneratorin e

Tiranës nuk ishte përcaktuar as data e dorëzimit të dokumenteve, as data e shpalljes së fituesit që, çuditërisht, e dinte vetëm treshja braziliane e tij, që ishte e vetmja, e cila kishte dorëzuar dokumentet dhe u shpall fituesja e vetme. Pra, në të gjitha këto mosdijenitë e tij Rama justifikoi vendimet që kishte marrë më tej. Vendimin më kryesor, atë të financimit, a e dini se me cilën firmë e ka bërë? Nuk e ka bërë me firmën e vet, sepse normal, qeverisja e ka mësuar të jetë i zgjuar, e ka bërë me firmën e Peleshit. Pra, njërin e detyron të jetë ministër kontraktor, autoritet kontraktor dhe e çon atje ku nuk duhet çuar; një tjetër e detyron që të firmosë në emër të tij, me qëllim që, kur situata të jetë e tillë, kur situata të jetë e vështirë.

Siç thashë në fillim, projektuesi, ideuesi dhe zbatuesi i kësaj skeme korruptive është ai dhe vetëm ai. A mendoni ju se në një qeverisje, ku ekziston një nukël mediatik “alla sigurim”, ku nuk mund të xhirosh një fjalë të vetme pa lejen e Ramës, të xhironin nën hundën e tij 430 milionë euro? A ka socialist në këtë sallë që e beson këtë, apo a ka socialistë përtej kësaj salle që e beson?! Është e pamundur. Autori kryesor, fajtori kryesor dhe penalitetin kryesor për këtë aferë e mban një dhe vetëm një person: ai është Edi Rama. Faleminderit!